



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe nenit 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit për bashkëpunim ndër komunal nr.04/L-010, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0008886/23 datë 31 janar 2023 për miratimin e kërkesës - nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, miratoi këtë,

### **VENDIM PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal të Komunës së Podujevës me Komunat;

- Komuna e Prishtinës,
- Komuna e Lipjanit,
- Komuna e Fushë Kosovës,
- Komuna e Graçanicës dhe
- Komuna e Obiliqit

#### **Neni 2**

Kryetari i Komunës autorizohet po ashtu për fillimin e konsultimeve me Komunat e cekura dhe përgatitjen e Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e nismës për bashkëpunim ndër - komunal, si dhe kompetencave të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

#### **Neni 3**

Marrëveshja nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, e njëjta procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës, ndërsa bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushteti Lokal dhe publikimit të të njëjtës.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.Prot. 01-020/05-0008887/23  
Podujevë, datë, 31 janar 2023**

